



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:266855

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05697472

Ac.nr.7554/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.R. nga Vushtrria, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së 13-të, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.9077/2021, të datës 30.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.9077/2021, i datës 30.09.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.9077/2021, të datës 30.09.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.R. nga Vushtrria dhe DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Polica e Kosovës, që paditësit në emër të shpërblimit të fundvitit-pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019 dhe 2020, për secilin vit t’ia paguaj shumën nga 565.21€, apo në shumën e përgjithshme për tri vitet në vlerë prej 1.695.63€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (16.11.2021) e gjer në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve procedurale t’ia

paguaj paditësit shumë në lartësi prej 124.00 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes-pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ta prish aktgjykimin C.nr.9077/2021 të datës 30.09.2022 dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 26.11.2021 ka ushtuar padi kundër të paditurës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura, me përgjigje në padi e ka kundërshtuar padinë e paditësit duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit të padisë dhe provave të bashkangjitura dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 398 të LPK-së pa shqyrtim kryesor të çështjes jashtë seancës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.9077/2021, të datës 30.09.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit me i datës 08.11.2021 i cili gjendet i bashkangjitur shkresave të lëndës dhe është i lëshuar nga e paditura për paditësin, nga i cili vërtetim gjykata konstatoi se paditësi tek e paditura realizon pagë mujore në shumë prej 556.21€, këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësit t’ia kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018. Vendimin për kamatën, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë,

për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyetimin. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe prezenca në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon dhe lartësia e pagës bazë, për çka edhe me rastin e vendosjes drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë Nr.04/L-076 nenet 44 dhe 45 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht të nenit 29 par.2 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13-të kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm, në të cilin nen shprehimisht parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe detyruar të paditurën që paditësit t’ia shpërblejë (kompensojë) 3 (tri) paga mujore në emër të pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 mbi bazën e vlerësimit të performances, të provuara përmes provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, personeli i policisë ka të drejtë nëshpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në Udhëzimin Administrativ me numër 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7554/2022, datë 30.04.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci